

VENDIM
Nr.1135, datë 5.8.2008

PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT

*(Nryshuar me vkm. nr..82, datë 27.01.2009; nr.531, datë 27.04.2009; nr.608, datë 08.07.2010;
nr.558, datë.11.08.2011; nr.504, datë 01.08.2012; nr.660, datë 26.09.2012; nr.578, datë
17.07.2013; nr.93, datë 19.02.2014)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 88 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit përcaktohen si më poshtë vijon:
 - a)Për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat për krimin e organizuar dhe krimet e rënda dhe Policinë Shkencore, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
 - b) Për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat për sigurinë publike dhe rendin publik, sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
 - c)Për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat për kufirin dhe migracionin, sipas lidhjes nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
 - d)Për punonjësit e Policisë së Shtetit në struktura të tjera policore dhe administrative e mbështetëse sipas lidhjes nr. 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Paga e bazë mujore për gradë (kolona 3 e lidhjes nr.1), është niveli i pagës së punonjësit të Policisë së Shtetit, në përputhje me gradën, që ka fituar.
3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolonat 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12 e 13 të lidhjes nr. 1), jepet sipas funksioneve, të përcaktuara në këtë lidhje.
4. Punonjësi i Policisë së Shtetit, për kohën e qëndrimit në gradë, përfiton shtesë për vjetërsi në punë, në masën 1 për qind, pas çdo viti pune. Masa e shtesës për vjetërsi në punë të jetë deri në nivelin e pagës bazë, të gradës pasardhëse.

Përlllogaritja e shtesës për vjetërsi në punë të fillojë në çastin e marrjes së gradës, sipas ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

5“Specialistët”, “Përgjegjësit e Sektorit”, apo “Drejtorët” në Policinë e Shtetit, që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së Policisë së Shtetit dhe kërkojnë në mënyrë të detyrueshme Diplomë të Nivelit të Dytë (DND) ose Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë (DIND) apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, mbi pagën mujore të gradës përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese, për pozicionet konkrete, bëhet pas miratimit paraprak nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.

Zbatimi i kësaj shtese për punonjësit aktualë, i miratuar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të vazhdojë deri në fund të vitit 2013.

5/1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, që pranohet në shkollën bazë të policisë, gjatë kohës së qëndrimit në shkollë përfiton trajtim me pagë, në masën 8000 (tetë mijë) lekë kur ka përfunduar arsimin e mesëm dhe 9000 (nëntë mijë) lekë kur ka përfunduar arsimin e lartë.

5/2. Punonjësi i Policisë mund të trajnohet brenda ose jashtë vendit, në kuadër të programeve të trajnimeve, të parashikuara e të organizuara nga institucioni. Kur punonjësi i Policisë së Shtetit, kryen kurse shkollimi ose trajnimi, brenda vendit, gjatë kohës së shkollimit/trajnimit përfiton pagën mujore të vendit të fundit të punës, para fillimit të kursit të shkollimit/trajnimit. Pagesa bëhet nga struktura e policisë, ku ka qenë efektiv përpara fillimit të shkollimit/trajnimit.

Kur punonjësi i Policisë së Shtetit kryen kurse shkollimi ose trajnimi jashtë vendit, për

periudha deri në 6 (gjashtë) muaj, merr pagën mujore të vendit të punës, para fillimit të kursit të shkollimit/trajnimit, ndërsa për periudha trajnimi mbi 6 (gjashtë) muaj, punonjësit të policisë i ndërpritet paga, por familjes së tij i jepet një shpërblim, si më poshtë vijon:

- a) Për punonjësit pa ose me një pjesëtar në ngarkim, 40 për qind të pagës mujore;
- b) Për punonjësit me më shumë se një pjesëtar në ngarkim, 50 për qind të pagës mujore.

Pagesa bëhet nga struktura e policisë, ku ka qenë efektiv punonjësi përpara fillimit të shkollimit/trajnimit.

5/3. Punonjësi i Policisë së Shtetit, që nuk është efektiv me kohë të plotë në institucionet e sistemit arsimor policor, por bashkëpunon me këto institucione si punonjës i jashtëm, për çdo orë mësimore 60-minutëshe, përfiton një page, si më poshtë vijon:

- a) Në kurset e shkollimit/trajnimit për kursantët e nivelit zbatues, në masën 300 (treqind) lekë/për orë;
- b) Në kurset e shkollimit/trajnimit për kursantët e nivelit të parë drejtues, në masën 400 (katërqind) lekë/për orë;
- c) Në kurset e shkollimit/trajnimit për kursantët e nivelit të mesëm drejtues, në masën 500 (pesëqind) lekë/për orë.

5/4 Punonjësit e policisë të cilët punojnë në strukturat e policisë shkencore, në zyrën e përgjimeve, në strukturat kundër antieksplozivëve dhe lëndëve të tjera plasëse, në strukturat e policisë së qarkullimit rrugor, si dhe mjekë e ndihmësmjekë në strukturat e Policisë së Shtetit, dhe punonjësit që administrojnë lëndë narkotike në magazinën qendrore të Policisë së Shtetit, si dhe punonjësit e prodhimit të vulave përfitojnë shtesë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin përkatës të pagave të punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.

6. Vendimi nr.558, datë 16.8.2006 i Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”, i ndryshuar, nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për politikat e pagave, për vitin 2008.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja Nr.1

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit në strukturat për Krimin e organizuar dhe Krimet e Renda dhe Policinë Shkencore

Niveli	Grada		Shtesa për natyrë të veçante pune e shërbimi										
		Paga baze për gradë	Ne funksione të Drejtorisë të Forcës së Posaçme. Oficere të Policisë Gjyqësore Pranë Prokurorisë për Krimet e Renda.	Ne funksione të Sektorit të Hetimit në Mbulim të Drejtorisë së Forcës së Posaçme	Ne funksione të Sektorit të Forcës së Posaçme dhe Kërkimi në Drejtorinë të Policisë së Qarkut Tirane	Ne funksione të Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve, Njësia Speciale operacionale për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.	Ne funksione të Sektorit të Përpunimit të Dhënave dhe Ndihmës në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve	Ne funksione të Analizës së Riskut dhe Informacionit Kriminal, Analizës së Riskut dhe Kartotekës të Drejtorisë së Policisë Shkencore.	Ne funksione të Policisë Shkencore në qarqe dhe komisariat e (nd.spec, laborant), Teknologjia dhe Përgjimi.	Ne funksione të Policisë Gjyqësore në qarqe	Ne funksione të luftës kundër Narkotikëve dhe Trafikeve, Krimin Ekonomik dhe Financiar, Akteve terroriste dhe Krimeve të Renda.	Ne funksione të Sektorit të Financës, Arkivit dhe Protokollit të Drejtorisë së Mbrojtjes së Dëshmitarëve	Ne funksione të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse për Departamentin për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Renda
Niveli i zbatues	Neninspektor	44500	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000		
	Inspektor	49000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000		
	Kryeinspektor	54500	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000		
Niveli i parë drejtues	Nenkomisar	65500	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000		
	Komisar	72000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000		
	Kryekomisar	87000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000	6000	3000
Niveli i	Drejtues	99000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000	6000	3000

mesëm drejtues	Drejtues i I-re	103000	22000	25000	20000	25000	15000	6500	8000	8500	9000		
-------------------	-----------------	--------	-------	-------	-------	-------	-------	------	------	------	------	--	--

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit

Niveli	Grada		Shtesa për natyrë të veçante pune e shërbimi									
		Paga baze për grade	Ne strukturat e Komisarariatit Special RENEA. Komisarariatit Special te Helikopterëve (Shef komisaritati dhe ne strukturat operacionale)	Ne strukturat e Komisarariatit Special RESI (Shef komisaritati. shefi planifikimit dhe operacionale)	Ne funksione te planifikimit përgatitjes dhe armatimit, Komisariate , RESI, Trupe shërbimi, ai dhe përgjegjës informacioni ne qarqe: Drejtori i Rendit, Sektori i Rendit dhe Sektori i Analizës se Riskut ne DPP, Sektori i Rendit Publik ne qarqe	Ne funksione te shërbimit Shëndetësore Kom RENEA Shef Sektori i Forcës se Posaçme Shqiponja dhe seksioni i FP Shqiponjave DP Qarkut Tirane	Ne funksionet për krimet dhe hetimin e krimeve, ne komisaritet NSH (Shef komisi dhe shef planifikimi. Koordinimin e operac dhe strukt operacionale) ne Drejtorinë e Forcës se lëvizshme operacionale, Shef stacioni si dhe specialist për hetimin e krimeve.	Ne funksione te policisë rrugore, Oficer patrulle e përgjithshme, trupe shërbimi ne seksione te informacionit ruajtjes dhe sigurimit te objekteve (RENEA RESI) Shef stacioni policisë Ndihmës-specialist, përgjegjës grupi: Trupe shërbimi shoqërues qeni, ai OPP; Specialist Rendi publik ne qarqe, Specialist Komandant grupi; Reparti i Sig Brendshme Ceremoniali, Seksioni i sigurisë se shoqërimit ne DPQ Tirane shef i seksionit te sigurisë publike, Trupe shërbimi ruajtje dhe sigurimin e objekteve ; Seksionit te Rendit	Ne funksione te ndihmës specialist, SPZ Specialist përgjegjës për SPZ. Ndihmës specialist, përgjegjës për dhomat e sigurisë. Trupe shërbimi. ndalim paraburgimi.	Ne funksione M sektor/seksion te shërbimeve te tretëve. Sektor/Seksione te sallës komandonit, Ndihmës-specialist për informacioni n përgjegjës turni: Specialist informacioni si dhe për marrjen c kallëzimeve, 'Trupe' shërbimi për trenat, ND-specialist ai dhe kujdestar. Nd spes përgjegj	Ne funksionet ndihmës specialist për zbatimin e vendimeve dhe kontrollin e armeve	

								Publik ne qarqe; Përgjegjës grupi , Seksioni i OASH, Spec shërbimi Perf diplom e tunelit krrabe.		grupi informacioni	
Niveli zbatues	Neninspektor	44500	40000	25000	6000	20000	9000	6300	7000	5500	5000
	Inspektor	49000	40000	25000	6000	20000	9000	6300	7000	5500	5000
	Kryeinspektor	54500	40000	25000	6000	20000	9000	6300	7000	5500	5000
Niveli i	Nenkomisar	65500	40000	25000	6000	20000	9000	6300	7000	5500	

pare drejtues	Komisar	72000	40000	25000	6000	20000	9000	6300	7000	5500	
	Kryekomisar	87000	40000	25000	6000	20000	9000	6300	7000	5500	
Niveli i mesëm drejtues	Drejtues	99000	40000	25000	6000	20000	9000	6300	7000	5500	
	Drejtues i I-re	103000	40000	25000	6000	20000	9000	6300	7000	5500	

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit

Niveli	Grada		Shtesa për natyre te veçante pune e shërbimi								
		Paga baze për grade	Ne funksione te Shef njësie Zv/shef njësie Seksioni I shërbimeve operacionale tokësore e detare te Njësisë se Lëvizshme territoriale	Ne funksione te hetimit te krimi Shërbimet operacionale dhe hetimit	Ne funksionet Drejtor i DRKM, Drejtor i Qendrës se Pritjes, se te huajve dhe Shef komisariati.	Ne funksione te shërbimit te kufirit dhe migracionit Seksioni I shërbimeve operacionale; Seksioni i pritjes trajtimi dhe sigurisë ne QP huajve	Ne funksione te sallave te komandimit dhe sallave operative, Shërbimi i qendrës nder institucionale operac detare Qendrat e shkëmbimit te informacionit Seksioni I rendit dhe sigurisë Trupe shërbimi ai dhe përgjegjës turni ne funksione te	Ne funksione mbështetëse			
Niveli zbatues	Neninspektor	44500	20000	7000	6500	6300	5500	3000			
	Inspektor	49000	20000	7000	6500	6300	5500	3000			
	Kryeinspektor	54500	20000	7000	6500	6300	5500	3000			
Niveli i pare drejtues	Nenkomisar	65500	20000	7000	6500	6300	5500	3000			
	Komisar	72000	20000	7000	6500	6300	5500	3000			
	Kryekomisar	87000	20000	7000	6500	6300	5500	3000			
Niveli i	Drejtues	99000	20000	7000	6500	6300	5500	3000			

mesëm drejtues	Drejtues i I-re	103000	20000	7000	6500	6300	5500	3000
----------------	-----------------	--------	-------	------	------	------	------	------

Lidhja Nr.4

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit

Niveli	Grada		Shtesa për natyre te veçante pune e shërbimi						
		Paga baze për grade	Ne funksione te shërb mbështetëse ne QFP. ne drejtorinë e QPMDH, Sektorit/seksioni t marrëdhënieve me publikun, Seksioni Administrimit te dokumentet dhe përfaqësimit	Ne funksione te IPQP. Drejtoria e Standardeve Profesionale, Drejtor I QPMDH Sektori I statistikave, ne funksione te Help desk, dhe shërbimeve	Ne funksione re Drejtorisë se Studimeve strategjike, Drejtor I QFP, Sektori I Shkollimit baze policor, Seksioni për trajtimin shkollimin e nivelit te pare, drejtues, Seksioni për trajnimin e shkollimin e nivelit	Ne funksione te Drejtorisë se Bashkëpunimit dhe koordinimit Ndërkombëtar, Asistent sekretari I Zv drejt te Përgjithshëm Shef sektori asistent I drejtorit te PQ Tirane.	Ne funksione te asistent / Sekret I Drejtorit te Përgjithshëm.	Ne funksione te Drejtor i Përgjithshëm, Zëvendës drejtor i Përgjithshëm, drejtor I Policisë si Qarkut Tirane.	Ne funksione te Drejtor Qarku Zv/drejtor Qarku dhe Shef komisarati.
Niveli zbatues	Neninspektor	44500	3000	5500	5000	6500			
	Inspektor	49000	3000	5500	5000	6500			
	Kryeinspektor	54500	3000	5500	5000	6500			
Niveli i pare drejtues	Nenkomisar	65500	3000	5500	5000	6500			
	Komisar	72000	3000	5500	5000	6500			8000
	Kryekomisar	87000	3000	5500	5000	6500			8000
Niveli i mesëm drejtues	Drejtues	99000	3000	5500	5000	6500	7000	17000	8000
	Drejtues i I-re	103000	3000	5500	5000	6500	7000	17000	8000
Niveli i larte	Zëvendës drejtori	115000						17000	

drejtues	Drejtor i Përgjithshëm	125000						22000	
----------	------------------------	--------	--	--	--	--	--	-------	--

